

EVALDA PACI

PROFILI KOMPLEKS I NJË SHQIPËRUESI NË NJË VARIANT TË *BUKOLIKAVE* TË VERGILIT (1932)¹

Shqipërimet e klasikëve grekë e romakë në një vështrim sistemor, por dhe diakronik reflektojnë më së pari një traditë ndihmesash që shërbejnë për të pasuruar vetë spektrin e receptimit të një letërsie të veçantë në motive siç konsiderohet me të drejtë ajo antike, e pasur në profile personazhesh dhe tematikash që frymëzuan në vijimësi dhe autorët më të rëndësishëm të letërsisë botërore të disa kohërave.

Kontributet ndaj përrimit të letërsisë klasike në botën letrare shqiptare gëzojnë një traditë solide në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, ndërkohë që vetë personaliteti (E. Haxhiademi) që këtë radhë qe shtysë për përpilimin e kësaj trajtëse paraqitet i lidhur mirëfilli me klasicitetin dhe antikitetin në formim, prirje dhe përzgjedhje argumentesh në punën e tij komplekse. Qasja ndaj antikitetit nga ana e Haxhiademit përbën një prirje sa të natyrshme, aq dhe të denjë për t'u ndjekur në vijimësinë e vet, e shprehur në të gjitha format me të cilat ai në mënyrë konkrete iu kushtua këtij argumenti dhe veprave që e mishërojnë atë në vështrimin e përpilimeve, gjinive letrare e shkrimore, autorëve përfaqësues që në mënyrë të pandashme i bashkohen këtij filli përmbajtësor e tematik. Haxhiademi

¹ P. Vergil Maroni, *Bukoliket, përkëthye nga latinishtja prej Etëhem Haxhiademit*, Elbasan, 1922; botuar prej Shtypshkronjës Kristo P. Luarasi, Tiranë, 1932.

paraqitet me një profil të pasur në elemente formimi që dëshmojnë një lidhje e afinitet të pazgjidhshëm me heronj e simbole të një bote sa të lashtë, aq dhe frymëzuese për autorë që ndërtuan subjekte e vepra të tëra mbi modele gjinore, por dhe shembuj bëmash që u transmetuan në shumë mënyra, madje dhe me variante botimi, deri në ditët më të fundit.

I edukuar që në gjenezë të formimit të tij me një prirje të qartë për të marrë sa më shumë nga kjo traditë e ndërthurur në nocione e simbole që evokojnë dhe tipare të përbashkëta gjuhësore e letrare, Haxhiademi e përjetëson rëndësinë e kësaj të fundit dhe në procese përpilimi e komponimi, duke iu kushtuar figurave që hynë të bënin pjesë e zhvillimeve dhe ngjarjeve më të rëndësishme për historinë e popujve në lashtësi. Kritika e kohës në vitet '30 të shekullit të kaluar reflekton jo pak opinione mbi receptimin e shkrimtarisë së tij, si dhe mbi gjini letrare që vijojnë të jenë reflektim i prirjes së sipërpërmendur së këtij autori të letërsisë sonë të shkruar.²

Duke ndërmarrë të shqyrtojmë një variant shqipërimi, për më tepër mbi një autor si Virgjili, që për hir të së vërtetës gëzoi pa ndërprerje interesin dhe vëmendjen e bibliofilëve dhe studiuesve të lashtësisë greke e romake, na u dha mundësia të marrim në analizë dhe aparatim me të cilin një punë e tillë është shoqëruar, fakt që paraqitet si një tjetër dëshmi e lidhjes së veçantë të Haxhiademit me letërsinë përkatëse dhe kontekstin që e mbështet atë.

I përveçëm në vështrimin tonë kësajsoj mbetet Publ Vergil Maroni-Publius Vergilius Maro (70 p.l.K.-19 p.l.K.), poeti që kujtohet për vepra-epope mbi historinë e Romës dhe më saktë, të një momenti mjaft domethënës për ardhmërinë e saj, por po aq të përveçme janë dhe gjinitë shkrimore që ky i fundit deshi të bënte

² Në jo pak sprovë dhe analiza në revistat shkencore e letrare të viteve '30 të shekullit të kaluar, komponimet e E. Haxhiademit janë ndër modelet e trajtuara dhe në vështrim të gjinive letrare që përurohen prej tij.

objekt të sprovave të tij, që për ata që e njohin këtë të fundit dhe në sajë të biografisë përkatëse, është më se e qartë që u shkruan dhe nën shtysën e një motivimi konkret.³

Rasti i Virgjilit në të vërtetë mbetet një dëshmi e ndikimit të qartë që dhe koha e rrethanat konkrete kanë pasur në fatin e shkrimtarëve, e kur bëhet fjalë për Publ Maronin, janë jo pak faktorë që i vijnë në kujtesë kritikut letrar e njohësit të mirë të veprës së tij. Ai diferencohet në disa pikëpamje nga poetë të erës së Augustit, i cili jo përherë qe koherent në qëndrimet dhe vlerësimet ndaj shkrimtarisë së këtyre të fundit, duke qenë deciziv me gjykimet e veta dhe në ecurinë përkatëse jetësore të tyre.

Një vepër e natyrës së Bukolikave ndërthen jo pak argumente diskutimi, ndër të cilat parësore mbetet vetë natyra gjinore e saj, konotacioni i përveçimit-titull (*Bucolicon liber*) që e përfaqëson atë, ndërkohë që dhe sjellja në gjuhën shqipe kërkon jo vetëm njohjen e një arsenali të specializuar si vetë leksiku i saj, por dhe përpjekje për realizim skemash metrike e ritmike që në rasë të letërsisë klasike janë të një veçanësie unike. Vetë titulli i veprës na orienton ndaj një fryme që të bën të imagjinosh kontekste të veçanta për personazhet dhe rrjedhojën e shtjellimit të saj, por dhe për një lidhje të natyrshme të shkrimtarisë së autorit me koncepte të kohës mbi të shkruarit në vargje, aq më tepër mbi përpilimin e një vepre si Bukolikat.

³ Duhet vënë në dukje dhe në këtë trajtesë tonën që lidhja e autorit (Virgjilit) me ngjarjet e epokës në të cilën jetonte receptohet dhe në përmbajtjen e Gjeorgjikave, një tjetër vepër e tij e ndarë në komponime, në të cilën lexohet qartë një motivim i tillë nga ana e tij. Përveç se të sjella në variante të kujdesuara filologjike në gjuhën latine, ndër të cilat do të mund të dallonim dhe kësobllat që u përruan në formate të ndryshme në proces të historisë së shkrimit në Evropë, veprat e këtij autori të periudhës së Augustit kanë ardhur dhe në përkthime që mbartin vlera të veçanta të formimit të përkthyesve përkatës, që mbeten në çdo rasë njohës të mirë të kulturës klasike e të skemave gjuhësore e letrare të saj.

Përposë faktit që mbetet vepër e një autori shumë të përmendur të letërsisë latine, motive të ngjashme me të Bukolikeve ndeshen dhe në realizimet më madhore të letërsisë klasike greke, qoftë dhe në ato që në fillimet e njohjes dhe për breza me radhë mendohet se janë transmetuar në rrugë orale.

Është e mundur që pikërisht në rasë të një hulumtimi të shtysave që pati vetë autori i sipërcituar të lëvrojë dhe këtë gjini letrare komplekse, të mund të reflektojmë dhe mbi njohjen nga ana e tij e sprovave paraprijëse, të rëndësishme për ta rindërtuar vetë historikun zhanror që i përket. Rimarrja në motive dhe referenca të motiveve të një autori si Teokriti, por dhe një lloj asimilimi i veçantë që reflektohet ndërkohë që Virgjili eksploron teknika specifike me të tilla vjersha, bën të mundur të gjykohet për gërshetime motivesh e elementesh që të gjendura në një vepër të përpiluar në gjuhën latine bart tipare e karakteristika inovative.

Letërsia latine në jo pak raste ofron mundësi për referim ndaj një tradite tjetër që është e pranishme në përpilimet në gjuhën latine herë për arsye të motivimit që ka frymëzuar vetë autorët, herë për arsye objektive të formimit të secilit në treva që i përkasin kulturës greke dhe formave të mendimit filozofik që e karakterizojnë atë.

E pranishme në jo pak dimensione dhe tipare jetësore, kultura greke shfaq ndikimet e veta dhe në format letrare e ato të dëshmimit shkrimor në botën romake, gjithashtu dhe në periudha që pasojnë ndarjen kohore që emërtohet zakonisht si ajo e latinishtes klasike, e afërt në kohë me veprimtarinë jetësore të Virgjilit, por e ndryshme në të tjera karakteristika kryesisht evolutive dhe përmbajtësore. Përfshirja në një kapërcyell jo të parandësishëm kohor, mjaft domethënës për vetë kthesën që po merrte gjithë riorganizimi shtetëror e social i Romës me fuqizimin gradual e të pakthyesëm të Oktavianit (Augustit të ardhshëm) i autorëve dhe poetëve që do të ndërmenden dhe me cilësimin përkatës që i kontekstualizon në pikëpamje letrarësie e

krijimtarie me kohën e perandorit zëmadh të Imperium-it romak, bën të mundur që dhe në dekadat që lidhen me një proces të tillë të ndihet një frymëmarrje e përveçme në pikëpamje të zhvillimeve letrare e më tej gjuhësore e tipologjike.

Ndër autorët latinë që kanë shkruar kryesisht në vargje, pikërisht ata të periudhës së Augustit dallohen për tipare unike në pikëpamje formimi dhe shkrimtarie, ndërkohë që Virgjili që mendohet ta ketë njohur më nga afër arkitektin e imperiumit madhështor romak, veçohet nga tradita studimore përkatëse dhe për arsye të ngjashme.

Po shpjegojmë me këtë rasë dhe arsyet e përzgjedhjes së temës së kësaj trajtесе, që mëton të jetë një homazh si për autorin latin që është lexuar e interpretuar aq shumë në shekuj, aq dhe për shqipëruesin Haxhiademi që shfaqet në dimensione të një personaliteti të formuar e të mbrujtur me elemente të një kulture mirëfilli evropiane, të përsosur në oficinën e përkthimtarisë dhe lëmimit të teknikave më sfiduese metrike.

Lidhjet motivuese të shqipëruesit me klasicitetin në të vërtetë përbëjnë një argument që kapërcen vetiu kufijtë e një trajtimi në rang kumtese, aq më tepër që një fakt i tillë ndihet të frymojë në një gamë të gjerë krijimtarie të Haxhiademit, siç dëshmohet nga një seri përpilimesh që mbartin tituj domethënës, e që së fundi patëm dhe rastin ta rikishim në duar falë një serie ribotimi të mirorganizuar dhe mjaft domethënës.⁴ I bërë objekt vëmendjeje për këto përpilime të tij dhe nga kritika e kohës, i rimarrë dhe në vështrime jo përherë të njëjta nga lexues të specializuar e njohës të letërsisë antike, Haxhiademi rivjen sërish në objektin e trajtimit tonë dhe si reflektues i rëndësisë që vijojnë të kenë në vështrimin tonë vepra e autorë të kësaj të fundit.

⁴ U referohemi në këtë rasë varianteve të ribotimit të veprave dhe botimeve të E. Haxhiademit në serinë e klasikëve të Botimeve Poeteka (Tiranë, 2019-2020), të konceptuara nga Silvana Leka, përgatitur për botim nga S. Leka, A. Leka, H. Haxhiademi-Pëllumbi.

Në këtë vështrim tonin për E. Haxhiademin si klasicist, nuk mund të mos vëmë në dukje ndër të tjera natyrshmërinë me të cilën ky autor kaq i vlerhtë trajton jetëshkrimin e autorëve të përzgjedhur dhe elemente qenësore të një bote si ajo romake.

Një fakt i tillë, që qëmtohet dhe në tekstet me të cilat introduktohen vepërzat e tij, si thesare të çmuara të një formimi të rrallë intelektual e kulturor dëshmon dhe një dukuri tjetër: njohjen e natyrshme mbi antikitetin që gjallonte ndjeshëm në mjediset nga e cila u frymëzua dhe shqipëruesi ynë.

Introduktimi i elementeve biografike të autorëve latinë, që mbetën dhe bashkautorë të një periudhe me rëndësi për historinë e Romës, e cila ka protagonistë të vetët shkrimtarë, mecenë, oratorë, politikanë e prijës të shquar, bën të mundur që të realizohet dhe ndërlihdja më se e domosdoshme mes gjuhës, letërsisë, qytetërimit, traditë që ka rezultuar mjaft fatlume dhe e dobishme në historikun e receptimit të gjuhëve klasike, në proces të studimit përkatës në shkollat më të mira evropiane. Rimarrja e këtyre elementeve nga ana e Haxhiademit bëhet dhe në funksion të reflektimit nga ana e tij mbi rigjetjen e të njëjtave modele në aktualitetin me të cilin përballej dhe në atë periudhë shkrimtari, shqipëruesi, eseisti dhe studiuesi i kësaj letërsie.

Kemi vlerësuar në këtë drejtim dhe ndërthurjen e natyrshme të elementeve të dy botëve në një shqipërim si ai i Bukolikeve të Virgjilit, të cilat dhe pse me një sërë veçantish që diktohen nga dukuri që kanë të bëjnë me origjinën e secilës dhe më tej me ecuritë që lidhen me një sërë faktorësh dhe historikë, përkojnë natyrshëm në sytë e komponimeve të këtij autori të periudhës së Augustit, që reflekton elemente të të dyja kulturave në kompozim, renditje, gërshetim tiparësh e veçorish që kanë të bëjnë dhe me gjininë e përzgjedhur prej tij. Autori i Eneadës (po përdorim në këtë rasë emërtesën e zgjedhur e të përdorur shpesh nga Haxhiademi) përfaqësohet në historinë e letërsisë së shkruar latine dhe me të tilla përpilime, po aq reflektuese të lidhjeve të tij

me një botë në ndryshim, që e përfshiu në disa dimensione dhe këtë të fundit.

Me shqipërimet e tij, por mbi të gjitha me transmetimin e ndjesive e frymëzimit që autorit tonë i vinin falë formimit të veçantë dhe në fushë të letrave klasike, ai ka vijuar e vijon t'i bëjë një shërbim të vyer edukimit humanist të brezave, formësimi i të cilëve mbetet i paplotësuar pa njohuritë mbi antikitetin dhe periudhat më të rëndësishme historike të tij.

Kjo vepër e Virgjilit, e krahasueshme në pikëpamje gjinie shkrimore, por dhe motivesh qendrore me krijimet që i kanë dhanë zanafillën krijimtarisë mbi këngët e barinjve paraqet për Haxhiademin një objekt të një interesi të veçantë, duke qenë se ky i fundit nuk ka kursyer të shtjellojë si elemente të biografisë së autorit të periudhës së Augustit, ashtu dhe veçori të përpilimit të një vepre që ndoqi një ecuri të pazakontë në pikëpamje përfundimi.

Për vetë rrugëtimin jetësor që i njihet në studime mbi personalitetin dhe veprën, por dhe faktin që ka qenë i përfshirë në trajtimin e madhështisë së imperiumit dhe vetë figurën e Oktavianit, Virgjili është bërë objekt trajtesash të shumta që kanë thirrur në kauzë antropologët më të mirë të antikitetit dhe historisë së një *imperiumi* që u përrua në atë shekull në të cilin jetoi ky autor.⁵

Duhet parë veçanërisht dhe periudha në të cilën sheh dritën e botimit një shqipërim i tillë, me gjasë i bërë objekt pune prej Haxhiademit disa vite më parë se të shihte dritën e shtypit kjo vepër e tija, që për elementet përmbajtësore dhe larminë e mjeteve gjuhësore e bën këtë të fundit bashkautor të një përpilimi

⁵ Bukolikët vërtet që mbartin një profil të rrahur më parë dhe në letërsinë greke, madje në disa vepra të saj, dhe pse mund të mos jenë konceptuar mirëfilli si këngë të barinjve, por Virgjili vetë transmeton në përpilimin e tij disa aspekte që dëshmojnë prirje të personalitetit të tij.

që evokon një frymë të veçantë, unike dhe për mbarë spektrin krijues të vetë Virgjilit.

Shqipërimet nga gjuha latine kanë qenë objekt interesi të vazhdueshëm në historinë e përkthimitarisë, në veçanti në lidhje me veprat madhore të letërsisë klasike. Bëhet fjalë për një kuadër të pasur në emra dhe arritje, të vijuara më tej me kontribute që bënë të mundur të promovoheshin në të njëjtën fushë të njëjtët kontribues, dhe pse në fushë të shqipërimit të veprave të shkruara në një latinishte më të vonë, të shekujve XV-XVI.

Vëllimi tematik që u bë këtë herë objekt i trajtesës sonë paraqitet i pajisur me elemente që i shërbejnë një domosdoshmërie përmbajtësore, siç dhe e kërkon vetë natyra e botimit, aq më shumë kur bëhet fjalë për një vepër të antikitetit. Një model i veçantë rindërtohet dhe metodikisht në një botim të tillë mbi Bukolikën, duke pasur parasysh se dhe elementet biografike që i paraprijnë leximit të shqipërimit janë më se të mirëpritura, të përpiluara me koncizitet, por dhe me një sens maturie që na shpie qoftë te autori, qoftë te periudha historike në të cilën ai jetoi.⁶

Botimi në fjalë i Bukolikave përmban dhe konsiderata të nevojshme për lexuesin e specializuar, ndër të cilat do të veçonim njohuritë e natyrës kulturore mbi historikun e gjinisë në të cilën sprovohet Virgjili, e përruar kohë më parë nga autorë të traditës greke, por që u ndërmor dhe nga autori ynë i periudhës së Augustit në rrethana pak a shumë të veçanta në rrugëtimin e tij jetësor. Qasjet ndaj autorëve paraardhës që njihen si promovues të një gjinie të tillë krijimtarië nuk mungojnë as në hyrjet kritike e të domosdoshme që prijnë shtjellimin e shqipërimit të Eklogave të Bukolikave, të cilat shihet qartë që Haxhiademi i ka ndjekur

⁶ Virgjili duhet t'i ketë përpiluar *Bukolikën* në vitet '42-39 para lindjes së Krishtit, pikërisht në një klimë luftërash civile të ashpra në Gadishullin Italik e që njihet si një periudhë aspak e qetë për Romën. Evokimet ndaj peizazheve, të lidhura dhe me vendlindjen e autorit, por dhe prirjet ndaj një jete të thjeshtë, të qetë, të veçuar reflektohen në pjesën më të madhe të pjesëve të veprës së tij.

dhe studiuar dhe në pikëpamje të kronologjisë së përpilimit, që sipas kritikëve dhe studiuesve të historikut të veprës nuk ka pasur një linearitet që duhet të përkonte me renditjen reale të tyre në përbërje të saj.

Është e nevojshme në rast shpjegimesh të tilla të receptohet roli dhe vendi i autorit (Virgjilit), që paraqitet i përfshirë drejtpërdrejt në ngjarjet që i paraprijnë momentit të ardhjes në pushtet të Oktavianit, që më tej do të emërtohet Augustus, një ofiq i zgjedhur prej atij e që do ta dallojë përfundimisht në historinë e studimeve mbi Romën e asaj periudhe. Dedikimet që kanë qenë shtysë dhe që të përpiloheshin eklogat që i përbëjnë Bukolikët janë të nënvizuara dhe në aparatën kritik të këtij botimi të vitit 1932, duke bërë që vetë shqipërimi të introduktohet me nota interesante për nga brendia, informacioni, por dhe gjuha e përdorur, bartëse tipareash që evokojnë klimën e periudhës që ka të bëjë dhe me Virgjinin, dhe me perandorin që dhe në këtë korpus krijimesh ndihet i pranishëm. Një lloj simbioze mes shqipëruesit dhe veprës përshkon tërë frymëmarrjen e këtij varianti bukolik në formë e përmbajtje, ndërkohë që shumë elemente të brendisë dëshmojnë rolin që ndërmerr ky i fundit në transmetimin ndaj lexuesit të të njëjtit pasion me të cilin ai ushqehet e frymëzohet gjatë punës së tij.

Në personazhe të caktuara të Eklogave të Bukolikave, arrihet të identifikohet ose të supozohet vetë autori, i cili vihet në disa role duke qenë vetë *artifex, faber* i kësaj vepre poetike, që paraqitet në nënndarje tipike për vetë natyrën e saj. Identifikimi prej Haxhiademit i këtyre dimensioneve karakteriale që merr Publius Maroni, i kushtëzuar nga vetë rrethanat jetësore të gjindet në disa ngjarje e kthesa të papritura e të përsëritura konsiderohen themelore dhe prej atij vetë, që shfaq sërish një njohje më se të motivuar ndaj veprës dhe biografisë së autorit.

Koha e përpilimit të secilës prej eklogave rimerret dhe në paraqitjen përmbajtësore të secilës, duke u bërë e mundur në të vërtetë dhe një rindërtim i krijimtarisë së Virgjilit, i cili ka

ngërthyer jo pak personazhe dhe momente jetësore në këtë vepër të tij. Në të vërtetë, një fakt i tillë duhet parë në një vështrim më përgjithësues nëse bëhet fjalë për të pasur një ide konkrete mbi kontributin e Haxhiademit në lidhje me një vepër të tillë. Brendësimi i krejt itinerarit të formësimit të kësaj vepre jo vetëm ndihet në çdo qelizë të angazhimit të Haxhiademit ndaj një krijimi të tillë, por dhe bën të mundur që shqipëruesi të ketë një rol vendimtar në receptimin e përmbajtjes së tij përballë lexuesit.

Një vepër si Bukolikata gëzon dhe një traditë të gjerë e solide rindërtimesh e trajtesash, në të cilat mbetet e pashmangshme dhe vënia në dukje e gërshetimit të prirjeve që së pari i gjejmë në një letërsi *par excellence* klasike si ajo greke, dhe në autorë në zë të saj, por më tej, me të njëjtën frymë por me terma paksa më të ndryshme në letërsinë latine që pati autorë që e pasqyronin ndjeshëm formimin apo frymëzimin nga pararendës të një letrarësie tipike, që gjen mundësi shprehjeje e konkretizimi në gjini si ajo e sipërcituara.⁷

Eklogat në vetvete kthehen në rimarrje të regjistrave mitologjike që priren dhe nga bota romake, dhe pse me referencë të qartë më së pari ndaj asaj greke.⁸

Në veçanti Ekloga II paraqitet me interes sa u përket qasjeve me tekstin latin referencial, ndaj të cilit në pamje të parë

⁷ Në këtë këndvështrim shihen të gërshetuara dhe në terminologjinë e shqipëruetit përdorime që evokojnë tipare të të dyja traditave letrare, ndër të cilat ajo greke del në pah në një sërë përveçimesh e subjektsh që ndërtojnë komponimet e Bukolikave. Eklogat, carmina-t, nëndarjet që paraqiten në një rend arsyetimi të interpretuar nga shumë studiues të veprës përmbajnë në ndërtimin alegorik të tyre jo pak elemente të tilla, që evokojnë natyrshëm qenësinë e kulturës antike dhe në formimin e shqipëruetit.

⁸ Mjaft i pasur në këtë vështrim leksikoni i vënë në përdorim nga Haxhiademi, i cili ruan një ekuilibër të qartë mes ndërtimesh në gjuhën shqipe dhe zërash që domosdoshmërisht duhet të vijnë nga bota që e ka frymëzuar të shqipërojtë. Haxhiademi ka kontribuar për një leksik të zgjeruar të botës së florës dhe faunës, por dhe të vetë sfondit idilik që rimërret në brendinë e eklogave të veçanta.

vihen re diferencime në variantin e shqipëruar, kur në të vërtetë bëhet fjalë për përzgjedhje fjalësh të përshtatshme në gjuhën shqipe nga ana e shqipëruesit. Për nga ndërtimet që i shërbejnë shqipëruesit në punën e tij, mbetet kjo e fundit ndër më të pasurat në shembuj që mund të qasen dhe ndaj pjesësh të tjera të veprës, të kujdesuara siç u tha dhe më parë dhe në aspekte të metrikës e prozodisë.

Në një vepër të kësaj natyre do të përmbahen natyrshëm elemente të një sfere të rëndësishme për botën antike dhe në këtë drejtim dhe shqipëruesi lë gjurmët e tij me përdorimet që zgjedh të përfshijë.

Ritet e flijimit gjejnë një shprehje të gjerë në përpilimet e autorëve antikë, gjithashtu dhe në autorët e letërsisë latine që kanë të bëjnë me periudhën e Augustit. Të gjithë kemi përshkuar bashkë me ta e bashkë me shqipëruesit një itinerar ndjesish e receptimesh që zgjohen teksa përmenden altaret, monumentet karakteristike e bashkëshoqëruese të një riti kaq të zakonit në antikitet, por dhe flitë që nuk duhet të mungojnë pranë këtyre të fundit. Virgjili u bashkëngjitet natyrshëm paraardhësve të vet që dhe shekuj më parë u kujdesën të përshkruanin me gjithë solemnitetin që i takon skenat e riteve të tilla, pa të cilat nuk do të kishin të njëjtin konotacion as veprat madhore të letërsisë antike greke e romake.

Në vështrimin e sotëm, veprat e letërsisë antike vijojnë të jenë personifikimi i një qytetërimi kompleks që pati prirjen të shtrihej në kufij gjeografikë të një konceptimi tjetër në kohë të lashta, në kuptimin e perceptimit të popujve që kishin epërsi pothuaj të deklaruar në periudhën e fuqizimit të tyre.

Autorët e letërsisë antike, në veçanti personalitete si ai i Publ Maronit, e ndërmerrnin dhe në proces të krijimtarisë së tyre lartësimin në virtyte dhe përmasa të madhësisë së prijësve të tyre, modeli i të cilit vijoi të ishte në mënyrë decizive Oktaviani, i mbiquajtur më vonë Augustus.

Do të receptohet ndjeshëm nga lexuesi i shqipërimin të Haxhiademit brishtësia e personazhit që në të vërtetë është dhe protagonist i eklogave më të rëndësishme të veprës në fjalë, po ashtu siç do të mund të receptohej dhe në proces të konsultimit të variantit në gjuhën latine, referent i pandashëm dhe në vazhdë të hulumtimeve tona mbi punën-model të përkthyesit. Do të shtonim me bindje të plotë që i frymëzuar nga vetë brendia e veprës së Virgjilit, shqipëruesi është pjesë e një procesi që ngërthen brendësimin e pasazheve të saj, por dhe të tjera përshtypje që në të vërtetë lidhen me vetë përjetimet e Publ Maronit që mbetet në syrin e historianëve të letërsisë augustiane një autor i sprovuar në vështirësi e përballje të forta shpirtërore. Jo rastësisht të tilla hollësi biografike vihen në dukje nga vetë Haxhiademi në notat introductive të shqipërimin të tij mbi këtë vepër.⁹

Janë pikërisht dhe dekadat që citohen dhe në këtë punim tonin që janë shënuar nga sprovat e Frano Alkajt, Henrik Lacës, Gjergj Fishtës, Viktor Volajt, Etëhem Haxhiademit, Ndre Mjedjes, Nikollë Dakës etj.

Çdo kontribut në një fushë aspak të thjeshtë përballjeje ka bërë të mundur të rinëvizohen vlerat dhe shprehësia e një gjuhe të pasur si shqipja, që në këto raste bëhet instrument dhe i zbatimit të skemave metrike të detyrueshme për t'u respektuar, duke qenë se bëhet fjalë për vetë skeletin që mban fort tekstet e veprave të klasikëve që sillen në këtë gjuhë.

⁹ Në pikëpamje tekstore, kjo parashtrësë që introdukon shtjellimin në variantin në gjuhën shqipe të Eklogave të Bukolikave përbën një model të arrirë që orienton lexuesin ndaj brendisë së veprës, por dhe e përaftron me ecurinë e përpilimit të saj. Një historik si ai i Bukolikave të Virgjilit përbën një prej argumenteve më të trajtuara dhe në pikëpamje të njohjes së shkrimtarisë së autorit, por dhe të biografisë së tij. Fryma e qartë e një klime që për autorin duhet të jetë e pasuruar në një sërë elementesh të botës së fshatit e të kullotave, pa lënë në harresë hyjnitë dhe kushtimet ndaj tyre përbën një veçori tematike të Bukolikave, që ndiqet hap pas hapi në ecurinë e shtjellimit të tyre.

Në të vërtetë, kjo periudhë e pasur në sprova për ta sjellë letërsinë antike dhe autorët e saj në vëmendjen që meritonte të kishte në pikëpamje të vlerave që përçon në edukim dhe formim individual, mbetet një gur miliar që shënon jo pak arritje në projektimin kompleks të kësaj tradite letrare, pa të cilën as zhvillime të mëvona letrare nuk do të kishin të njëjtën ecuri e reflektim në modele e vepra.¹⁰

Mëton dhe kjo sprovë jona, e mbrujtur me elemente konsiderimi dhe reflektime modeste, të vërë në dukje kompleksitetin e një kontributi që u shtri dhe u konkretizua në disa gjini e vepra, duke bërë të mundur të shtjellohen një sërë vetish krijuese të një personaliteti që duhet të qëndrojë në mënyrë të vijueshme në kujtesën e kohëve tona, bashkë me faktin që dhe vetë studimet tona duhet ta kenë atë pjesë të një mozaiku që në periudhën në të cilën jetoi Haxhiademi, u plotësua natyrshëm nga një sërë figurash të denja për t'u përkujtuar e celebruar dhe në veprimtari shkencore si kjo e sotmja.

BIBLIOGRAFI

- Bettini, M., Short, M.V., *Con i romani. Un'antropologia della cultura antica*, Il Mulino, Bologna, 2014.
- Haxhiademi, E., *Lyra (poezi)*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2019.
- Haxhiademi, E., *Diomedei; tragjedi me pesë akte*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2020.
- Haxhiademi, E., *Aleksandri; tragjedi me pesë akte*, Botimet Poeteka, Tiranë, 2020.

¹⁰ Një mundësi të mirëfilltë qasjeje e reflektimi të këtyre motiveve do të gjinden dhe në përpilimet e autorëve si Petrarca e Boccaccio. Vepra me titull *Bucolicum carmen* e F. Petrarçës, e shkruar në gjuhën latine dhe e përpiluar mes viteve 1346-1364, e ndërtuar në rreth 12 ekloga, e bërë objekt studimi e ribotimi në një sërë sprovash filologjike e kritike, mbart qartësisht ndikimin frymëzues të Bukolikave e Gjeorgjikave të Virgjilit.

- Foresti, A., “Il ‘Bucolicum carmen’ di Francesco Petrarca, stampato a Cremona nel 1495”, në *Bibliofilia*, v.20, n.10-12, Leo Olschki editore, Firenze, 1919.
- La Penna, A., *Epos e civiltà del mondo antico*, Loescher editore, Torino, 1990.
- Marchetta, A., *Due studi sulle Bucoliche di Virgilio*, GEI editrice, Romë, 1994.
- Marone, Virgilio, *Le Bucoliche (per cura di C.Landi, con testo e commento)*, Le Monnier editore, Firenze, 1925.
- Maroni, P.V., *Bukoliket, përkëthye nga latinishtja prej Etëhem Haxhiademit*, Elbasan, 1922; botuar prej Shtypshkronjës Kristo P.Luarasi, Tiranë, 1932.
- Marone, P.V., *Le Bucoliche, (introduzione, commenti di A. Cucchiarelli, traduzione di A.Traina)*, Carocci editore, Romë, 2017.
- Mirdita, Z., *Mitet dhe mitologjia në antikë*, Rilindja, Prishtinë, 1988.
- Nirvana, V., “Etëhem Haxhiademi - dramaturg humanist”, në *Minerva*, nr. 23-24, Tiranë, 1934.
- Nirvana, V., “Viti mendor 1936”, në *Përpyjekja shqiptare*, n.4-6, 1937.
- Nirvana, V., “‘Abeli’ dhe ‘Lyra’ të Etëhem Haxhiademit (ndërshtypje e gjykime)”, në gazetën *Tomori*, nr. 19, 24 mars 1940.
- Paci, E., *Le traduzioni dal latino (medievale ed ecclesiastico) all'albanese: un panorama descrittivo*, Bulzoni editore, Romë, 2009.
- Paci, E., “Per una storia delle traduzioni in lingua albanese dalla Bibbia e da classici greci e latini”, në *Classica et Christiana*, Universiteti i Iasit, n.4, 2009.
- Paci, E., “Për një studim të thelluar dhe përmbajtësor të elementeve institucionale të gjuhës latine”, në *Buletin shkencor, Seria e Shkencave shoqërore*, n. 68, Shkodër, 2018.

- Paci, E., “Për një vështrim antropologjik dhe gjuhësor të nocioneve themelore të botës romake dhe latine në tekstet universitare shqiptarë”, në *Buletin shkencor, Seria e Shkencave shoqërore*, n. 69, 2019.
- Paci, E., *Gjurmime filologjike mbi latinitetin dhe shkrimet e vjetra shqipe*, Botime Françeskane, Shkodër, 2020.
- Petrarca, F., *Il Bucolicum carmen e i suoi commenti inediti, a cura di A. Avena*, Arnaldo Forni editore, Bologna, 1970.
- Petrarca, F., *Laurea occidens, Bucolicum carmen X; testo, traduzione e commento a cura di G.Martellotti*, Edizioni di storia e letteratura, Romë, 1968.
- Petrarca, F., *Bucolicum carmen, a cura di L.Canali*, Manni editore, Romë, 2005.
- Poliziano, A., *Commento inedito alle “Georgiche” di Virgilio (a cura di L.Castano Musicò)*, Leo Olschki editore, Firenze, 1990.
- Plangarica, T., *Univers i vlerave të munguara*, Botime Sejko, Tiranë, 2002.
- Riganti, E., *Lessico latino fondamentale*, Pátron editore, Bologna, 1989.
- Rosati, G.P., “Punto di vista narrativo e gli antichi esegeti di Virgilio”, në *Annali della Scuola Normale Superiore di Pisa*, n. 2, 1079.
- Schirò, G., *Storia della letteratura albanese, Nuova Accademia editrice*, 1959.
- Shtylla, B., “Tragjeditë e Haxhiademit”, në *Shkëndija*, nr. 4. Tiranë, 1941.
- Taro, E., “Etëhem Haxhiademi”, në *Tomorri i vogël*, nr. 6, 1942.
- Tommaseo, N., *Bucoliche e Georgiche di Virgilio (traduzioni edite e inedite)*, a cura di D.Martinelli, U.Guanda editore, Milano, 2011.
- Torelli, M., “L’Etruria di Virgilio: immaginario e realtà”, në *Mélanges de l’École française de Rome*, n.1, 2017.

Vecce, C., “Il latino e le forme della poesia umanistica”, në *Manuale di letteratura italiana (storia per generi e problemi)*, V. I, Bollati Boringhieri, Torino, 1993.

Virgilio, *Le Bucoliche (testo latino e traduzione in versi italiani di G. Albin)*, Zanichelli editore, Bologna, 1943.